



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI " FAN S. NOLI "  
KORÇË**

---

**Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580  
Web: [www.unkorce.edu.al](http://www.unkorce.edu.al) e-mail: [rektorati@unkorce.edu.al](mailto:rektorati@unkorce.edu.al)**

**MIRATOHET:**

**REKTORI**

**Prof. as. dr. GJERGJI MERO**

**FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE**

**PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË  
"MASTER SHKENCOR NË FILOZOFI SOCIALE"**

**Dekani  
Prof. Dr Gjergji Pendavinji**

**Përgjegjësi i Njesisë Bazë  
Doc. Ardian Matka**

**VITI AKADEMIK 2014-2015**

# **1. EMËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT: “MASTER SHKENCOR, NË FILOZOFI SOCIALE”**

## **2. VENDIMET E ORGANEVE PËRGJEGJËSE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT:**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 351, dt. 12.05.2010, vendosi: Hapjen e programit të ciklit të dytë, në “Filozofi Sociale”;

**Vendim i Këshillit të Fakultetit për hapjen e programit të studimit “Master Shkencor në Filozofi Sociale”;**

**Vendimi i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, për hapjen e programit të studimit “Master Shkencor në Filozofi Sociale”.**

## **3. OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MUNDËSITË QË AI I OFRON STUDENTIT PËR PUNËSIM**

Kursi i ciklit të dytë të studimeve “Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) në Filozofi Sociale” synon të rritë më tej nivelin e formimit akademik të studentëve, aftësimin profesional dhe kualitetet që kërkon tregu intelektual i punës në vend.

Programi zgjeron gamën e informimit konceptual, filozofik e social, formon dhe zhvillon aftësitë intelektuale në diskutimin profesional të çështjeve të kësaj fushe, zgjeron njohjen sociale mbi funksionimin dhe drejtimin institucional, formon shprehje komunikimi e ndërveprimi kulturor me individë, grupe e shtresa shoqërore tek studentët që do të përfshihen në këtë program.

Gjithashtu Programi “DND në Filozofi Sociale” synon të formojë dhe zhvillojë kompetencën në fushën e kërkimit shkencor, të metodologjisë së kërkimit cilësor e sasior duke ofruar njohuri mbi teknikat moderne të kërkimit. Në këtë kuadër studentët do të aftësohen në rrugën e punimeve kërkimore por edhe të zhvillimit të mëtejshëm në përgatitjen e tezës së doktoraturës.

Programi synon gjithashtu të realizojë një njohje sa më të gjerë të shoqërisë dinamike që ndryshon në mënyrë të shpejtë, të proceseve e faktorëve kushtëzues, të marrëdhënieve shoqërore në

kuadrin e sistemit të vlerave kulturore e të problematikës që lidhet me njeriun dhe botën në ndryshim.

Programi synon të formojë dhe zhvillojë tek studentët disa kompetenca në këto fusha:

**a.** Thellimin e njohurive, specializimin dhe ngritjen e nivelit akademik në fushën e filozofisë dhe shkencave sociale.

**b.** Zhvillimin e kompetencës në fushën e kërkimit në shkencat sociale me synimin e vijimit të mëtejshëm të karrierës drejt programit të doktoraturës.

**c.** Zhvillimin e kompetencës në fushën institucionale, të administrimit publik, menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësive të drejtimit etj.

**d.** Zhvillimin e aftësive për komunikimin social, marrëdhëniet me publikun, masmedian etj.

#### **Mundësitë për punësim të diplomës “DND në filozofi sociale”:**

- Institucionet publike : administratë publike (sektorët e burimeve njerëzore, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve me jashtë, zhvillim projektsh sociale etj.)
- Organe qendrore: Ministria e Jashtme, Ministria e Punës dhe e Shanseve të Barabarta, Ministria e Integritimit.
- Ministria e Arsimit: shkolla të mesme, shkolla të larta, universitete, institucione kërkimore.
- Media
- Pushteti qendror
- Pushteti lokal: (Prefektura, Këshilla Qarqesh, Bashki etj).

Programi synon të aftësojë studentët me kapacitetin e nevojshëm intelektual dhe shkathtësitë e debatimit të çështjeve që lidhen me zhvillimet sociale duke përpunuar e gjeneruar ide të reja, programe studimi e zhvillimi rajonal e kombëtar, aftësi për përpunim e hartim strategjish zhvillimi në sektorët përkatës për vitalizimin dhe optimizimin e faktorëve socialë e ndërkohë programi synon të zhvillojë edhe aftësitë e drejtimit.

#### 4. STRUKTURAT AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

<p><b>Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore</b></p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane</p>
<p><b>Strukturat e tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë</b></p>	<p>Ministria e Arsimit Bashkëpunimi i ngushtë midis Fakulteteve të Universitetit tonë, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, Fakulteti Ekonomik dhe departamenteve përkatëse të këtyre Fakulteteve Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës Institucinet dhe Organet vendore të Qarkut</p>
<p><b>Subjekte të tjera publike apo private.</b></p>	

## 5. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “Master Shkencor në Filozofi Sociale”  
 zgjat 2 vite akademike, 4 semestra, 60 javë mësimore, 120 kredite.  
 Konkretisht:

## 6. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT, CIKLI I DYTË “Master Shkencor në Filozofi Sociale”, VITI AKADEMIK 2013-2014

### Kursi I (i parë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprimtarisë	Kreditet	Leksion	Seminar	Laborator	Total	Semestri	Frekuentimi
1	Metodat e Kërkimit në Shkencat sociale	B	8	50	25		75	I	I Detyruar
2	Institucionet dhe Bazat e së Drejtës Administrative	A	6	40	20		60	I	I Detyruar
3	Probleme të Moralit	B	7	50	25		75	I	I Detyruar
4	Filozofia e Gjuhës	B	7	50	25		75	I	I Detyruar
5	Natyra, Kultura, Historia	C	7	50	25		75	II	I Detyruar
6	Antropologji Filozofike e Thelluar	B	7	50	25		75	II	I Detyruar
7	Diskursi Filozofik Bashkëkohor	C	7	50	25		75	II	I Detyruar
8	Politikat Sociale të BE	A	6	40	20		60	II	I Detyruar
9	Aftësi Drejtimi Men. i B. Njerëzore	D	8	50	25		75	II	Me Zgjedhje

	Proceset Urbanizuese								
	<b>GJITHSEJ</b> <b>(Kursi i parë)</b>	<b>9</b>	<b>63</b>	<b>430</b>	<b>215</b>		<b>645</b>	<b>I+II</b>	

**Kursi II (i dytë)**

<b>Nr.</b>	<b>Disiplina apo titulli i veprimtarisë</b>	<b>Tipi i veprimt</b>	<b>Kred</b>	<b>Leks.</b>	<b>Sem.</b>	<b>Lab.</b>	<b>Tot.</b>	<b>Simestri</b>	<b>Frekuentimi</b>
1	Psikologji e Komunikimit dhe Zgjidhja e Konfliktëve	<b>C</b>	6	40	20		60	III	I Detyruar
2	Teori Komunikimi Ndërkulturor	<b>B</b>	7	50	25		75	III	I Detyruar
3	Filozofi e së Drejtës	<b>B</b>	7	50	25		75	III	I Detyruar
4.	Gjuhë Angleze	<b>E</b>	4	10	40		50	III	I Detyruar
5.	Informatikë	<b>E</b>	4	10	30		40	III	I Detyruar
6.	Praktikë Institucionale	<b>E</b>	4	-	-		55	III	I Detyruar
7.	Punimi i Diplomës	<b>F</b>	25				300	IV	I Detyruar
	<b>GJITHSEJ</b> <b>(Kursi i dytë)</b>	<b>7</b>	<b>57</b>	<b>160</b>	<b>140</b>		<b>655</b>	<b>III+IV</b>	
	<b>Gjithsej KI+KII</b>	<b>16</b>	<b>120</b>	<b>400</b>	<b>260</b>		<b>1300</b>	<b>I-IV</b>	

## **15. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT**

**Sallat e leksioneve dhe të seminareve:** Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Fakulteti Ekonomik

**Biblioteka:** Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit, Fakulteti Ekonomik

**Sekretaria Mësimore:** Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane

**Departamenti:** Shkencave Sociale, Departamenti Gjuhë-Letërsi, Departamenti Menaxhim, Departamenti i Gjuhëve të Huaja,

### **Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë në programin e studimit të ciklit të dytë**

a.-Diplomë e sistemit të vjetër në Filozofi-Sociologji, Psikologji, Shkenca Politike, Ekonomiks, Histori, Gazetari, Gjuhësi, Letërsi, Gjuhë e huaj, Shkenca Edukimi, Drejtësi, Artet.

b.-Diplomë e nivelit të parë Filozofi-Sociologji, Psikologji, Shkenca Politike, Ekonomiks, Histori, Gazetari, Gjuhë-Letërsi, Gjuhë te huaja, Shkenca Edukimi, Drejtësi, Artet.

### **Kriteret specifike të pranimit të studentëve në program**

Nr.i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	25
Nr.minimal i studentëve për hapjen e programit	15

### **Kritere të tjera pranimi**

1	Nota mesatare minimale	8 ose 7,5
---	------------------------	-----------

## **Paketa me udhëzimet për procedurat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së mikrotezës për diplomën DND “Filozofi-sociale”.**

### **1. HYRJJE**

Për të fituar diplomën DND në Filozofi - Sociale, studentët që ndjekin programin përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit duhet të mbrojnë edhe një punim shkencor. Paketa që po ju paraqitet përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të mikrotezës, përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie.

### **2. Përgjegjësitë e palëve të përfshira në procesin e mikrotezës.**

#### **Përgjegjësitë e Departamentit të Shkencave Sociale (DSHS)**

\*Të krijojë komisionin e Mikrotezës i cili është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e procedurave të përgatitjes dhe të mbrojtjes së mikrotezës.

\*Të mbështesë Komisionin e Mikrotezës për zbatimin e udhëzimeve të përgatitjes dhe të mbrojtjes së mikrotezës.

\*Të mbikqyrë veprimtarinë e Komisionit të Mikrotezës.

\*T’u ofrojë studentëve mbështetjen dhe kushtet e nevojshme për realizimin e punimit të mikrotezës.

#### **Përgjegjësitë e Komisionit të Mikrotezës.**

1. Të hartojë udhëzimet e procedurave të përgatitjes dhe të mbrojtjes së mikrotezës.
2. Të hartojë çdo vit një listë me temat që janë në studim.
3. Të garantojë se temat e propozuara janë të përshtatshme për fitimin e diplomës.
4. Të kujdeset se të gjithë studentët kanë udhëheqësin e kërkimit.
5. Të respektojë rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të mikrotezës. (Si rregull, udhëheqës i mikrotezës caktohet një pedagog i Departamentit të Shkencave Sociale të Fakultetit të Mësuesisë të Universitetit të Korçës, ose i një universiteti tjetër që mban titullin “Profesor”, “Profesor i Asociuar”, gradën “Doktor”, një studiues me titullin “Drejtuues kërkimesh”, “Mjeshtër kërkimesh”, me gradën “Doktor” që është njohës i mirë dhe kontribues i fushës nga e cila është marrë tema që ai ngarkohet të udhëheqë. Në rastet kur udhëheqësi i propozuar ka gradën master do të caktohet një bashkëudhëheqës me titull nga stafi i shkollës.



6. Të garantojë se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij.
7. Të garantojë se udhëheqësit e temëve nuk janë të mbingarkuar me udhëheqje diplomash.
8. Të përcaktojë numrin maksimal të udhëheqjeve për një udhëheqës.

11. Të bëjë kritikën e duhura për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së diplomës të konfirmojë se kërkimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e gradës.

12. Të vërtetojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e komisionit të vlerësimit kur ai e ka kthyer punimin për riparaqitje.

13. Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga kërkimi i tij.

14. Të menaxhojë fondet e kërkimit nëse janë siguruar të tilla.

#### **Përgjegjësitë e studentit.**

1. Të jetë i familjarizuar me rregullat e procedurave të mikrotezës.
2. Sapo të ketë përcaktuar fushën e kërkimit, ai duhet të kërkojë një udhëheqës si rregull nga stafi akademik ose nga bashkëpunëtorët e Departamentit të Shkencave Sociale.
3. Të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për mikrotezën.
4. Të punojë fort dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të përfunduar punimin në kohën e duhur.
5. Studenti duhet t'i paraqesë nëpërmjet udhëheqësit Komisionit të Mikrotezës një raport të punës së kryer çdo muaj.
6. Të kompensojë të gjitha nevojat financiare për mbrojtjen e mikrotezës.

### **3. Struktura e punimit shkencor**

Punimi shkencor duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:

\*Abstrakti

\*Mirënjohja

\*Tabela e përmbajtjes

\*Studimi

- Hyrja
- Lista e tabelave, diagrameve, shtojcave
- Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes
- Metodologjia
- Rezultatet e studimit
- Diskutimi
- Përfundime dhe propozime

- Bibliografia
- Shtojca

### **3.1. Abstrakti**

Çdo punim duhet të përmbajë një abstrakt. Abstrakti duhet të jetë një përmbledhje që paraqet pikat kryesore dhe përfundimet e punimit. Abstrakti duhet të vendoset para falenderimeve dhe tabelës së përmbajtjes.

### **3.2. Mirënjohja**

Duhet paraqitur mirënjohja për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e punimit dhe financimin e tij.

- Përcaktuar nëse materiali është i përshtatshëm për botim;
- vlerësuar formimin e kandidatit në fushën e kërkimit dhe interesat e tij kërkimore.

### **Mbrojtja e punimit është publike**

Proçedura e mbrojtjes së mikrotezës përfshin:

- a. Paraqitjen e përmbledhur të punimit nga kandidati për 10-15 minuta.
- b. Paraqitjen e vlerësimit nga udhëheqësi shkencor.
- c. Pyetje dhe përgjigje rreth punimit.
- d. Vlerësimi i recensentit.
- e. Vlerësimi i jurisë.

## **Vlerësimi i punimit**

### **6.2.1. Ngritja e Komisionit të Vlerësimit**

Udhëheqësi shkencor i propozon Përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Sociale anëtarët e Komisionit të Vlerësimit me një përshkrim të shkurtër për ta. Komisioni përfshihet nga tre pedagogë të DSHS të Fakultetit të Mësuesisë, të Universitetit të Korçës ose specialistë të fushës që punojnë në institucione shkencore, një duhet të jetë i brendëshëm dhe dy duhet të jenë të jashtëm. Njëri prej anëtarëve të komisionit caktohet si recensent. Përgjegjësi i DSHS ia paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit të Mësuesisë komisionin të mbrojtjes së mikrotezës.

### **6.2.2. Kriteret e vlerësimit**

Për vlerësimin e punimit të mikrotezës anëtarët e jurisë dhe recensenti duhet të mbajnë parasysh këto kritere

- qasjen kritike të çështjes së zgjedhur duke demonstruar njohuritë dhe përvojën që zotëron studenti;
- demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur;
- përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumentave të kërkimit;
- origjinalitetin e punimit;
- dobitë e punimit;

- cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit;
- paraqitjen e qartë dhe formimin e një tërësie koherente; (respektimi i kërkesave të formatit dhe kërkesave teknike);
- cilësinë e prezantimit.

### **6 .2.3.Vlerësimi i mikrotezës bëhet me sistemin e pikëve:**

91-100	pikë	nota 10
81-90	pikë	nota 9
71-80	pikë	nota 8
61-70	pikë	nota 7
51-60	pikë	nota 6
41-50	pikë	nota 5

### **6 .3. Riparaqitja e punimit**

**6 .3.1.** Në rastet kur punimi nuk i plotëson standardet shkencore dhe etike, studentit mund t'i kërkohet një mbrojtje e dytë. Komisioni i Vlerësimit mund të rekomandojë plotësime dhe përmirësime të punimit. Në raste të tilla studentit i caktohet një kohë shtesë për të plotësuar vërejtjet. Punimi i përmirësuar riparaqitet në sesionin e radhës të mbrojtjes së mikrotezaave.

**6 .3.2.** Studenti që vlerësohet me notën katër në mbrojtjen e punimit të mikrotezës ka të drejtë të riparaqitet në mbrojtjen e saj në vitin pasardhës.

**6 .3.3.** Kandidati që rrëzohet për herë të dytë në mbrojtjen e mikrotezës e humbet të drejtën e marrjes së diplomës.

### **Mosmarrëveshjet e jurisë**

Kur ka mosmarrëveshje midis anëtarëve të jurisë për përmbushjen e standardeve të punimit, atëhere Përgjegjësi i DSHS i kërkon Dekanit miratimin edhe të një anëtari tjetër jurie.

### **Rezultatet e mbrojtjes**

Rezultatet e mbrojtjes së mikrotezës i përcillen studentit formalisht nga sekretaria e Fakultetit të Mësuesisë (FM)